



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 9 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i Redaktuar Publik i Vendimit Përmbledhës mbi [REDAKTUAR] dhe
Kërkesën për Shtyrje të Afatit në lidhje me Detyrimet për Nxjerrjen e Materialeve**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Zhan-Lui Zhilisen

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 21(6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 81(1)(a)-(b), 95(2)(b), 102(1)(b), dhe 107(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,² Prokurori i Specializuar paraqiti Aktakuzën e Konfirmuar.³
2. Më 16 mars 2021, në vijim të vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,⁴ Pjetër Shala (“z. Shala”) u arrestuar në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjika”).⁵
3. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) në Hagë, Holandë.⁶

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe ex parte. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni publik u nxorën më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED and F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe ex parte, dhe shtojcën 2, konfidenciale. Versioni me më pak redaktime dhe versioni i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01, konfidencial, F00016/A02, publik.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u nxor më 6 maj 2021, F00008/RED. KSC-BC-2020-04, F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe ex parte. Versioni i redaktuar publik u nxor më 15 prill 2021, F00008/A01/RED.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me shtojcat 1-2, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u nxor më 26 prill 2021, F00019/RED.

4. Më 30 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me Të ("Vendimi Kornizë"),⁷ me të cilin, ndër të tjera, urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") që deri më 30 korrik 2021 të përfundonte nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(b) të Rregullores.⁸

5. [REDAKTUAR].⁹

6. Më 31 korrik 2021, ZPS-ja i parashtrori Gjykatësit të Procedurës Paraprake një njoftim në lidhje me nxjerrjen e materialit të rregullës 102(1)(b), dhe kërkoi në vijim shtyrjen e afatit lidhur me detyrimin e nxjerrjes së disa materialeve të caktuara ("Kërkesa për Shtyrje të Afatit").¹⁰ Mbrojtja u përgjigj më 16 gusht 2021 ("Përgjigjja").¹¹

II. PARASHTRIMET

7. ZPS-ja parashtron se një numër i vogël materialesh të rregullës 102(1)(b) janë objekt i kërkesave të pazgjidhura ose të pritshme për masa mbrojtëse [REDAKTUAR] dhe kërkon shtyrjen e afatit për nxjerrjen e këtyre materialeve [REDAKTUAR].¹² Gjithashtu, sipas ZPS-së, 21 materiale të rregullës 102(1)(b) janë objekt i kufizimeve sipas rregullës 107, dhe ZPS-ja kërkon shtyrjen e afatit lidhur me detyrimin e nxjerrjes së këtyre materialeve, në mënyrë që të shqyrtojë përgjigjet e dhënësve të informacionit dhe të marrë prej tyre autorizim për nxjerrjen dhe përdorimin e tyre gjatë gjykimit,

⁷ KSC-BC-2020-04, F00033, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të Lidhura me Të*, 30 prill 2021, publik.

⁸ Vendimi Kornizë, para. 45, 92(c).

⁹ [REDAKTUAR].

¹⁰ KSC-BC-2020-04, F00057, Prokurori i Specializuar, *Njoftim për Gjykatësin e Procedurës Paraprake në lidhje me Nxjerrjen e Materialeve sipas Rregullës 102(1)(b) dhe Kërkesë për Shtyrje të Kufizuar të Afatit lidhur me Detyrimin për Nxjerrjen e Provave të Caktuara*, 31 korrik 2021 (njoftuar më 2 gusht 2021), rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial u parashtrua më 4 gusht 2021, F00057/CONF/RED.

¹¹ KSC-BC-2020-04, F00062, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Shtyrje të Afatit lidhur me Detyrimin për Nxjerrje të Materialit*, 16 gusht 2021 (njoftuar më 17 gusht 2021), publike.

¹² Kërkesa për Shtyrje të Afatit, para. 2.

përfshirë përgjigjet që kërkojnë zbatimin e redaktimeve.¹³ Së fundi, ZPS-ja njofton se disa përkthime në shqip të deklaratave të mëparshme të dëshmitarëve janë në kryerje e sipër dhe do të nxirren pa vonesë sapo të jenë gati, dhe se versionet në gjuhën angleze tashmë janë nxjerrë.¹⁴

8. Mbrojtja nuk kundërshton shtyrjen e afatit lidhur me detyrimin e ZPS-së për nxjerrjen e materialeve që janë objekt i kërkesave të pazgjidhura ose të pritshme për masa mbrojtëse [REDAKTUAR].¹⁵ Në këtë aspekt, Mbrojtja kërkon t'i miratohet qasje në kërkesat për masa mbrojtëse, me redaktimet e duhura në qoftë se është e nevojshme, si dhe t'i jepet mundësi për të bërë parashtrime përpara se këto masa mbrojtëse, në qoftë se miratohen, të zbatohen në procesin gjyqësor aktual.¹⁶ Për më tepër, Mbrojtja nuk kundërshton shtyrjen e nxjerrjes së 21 materialeve të rregullës 102(1)(b) që janë objekt i kufizimeve sipas rregullës 107.¹⁷ Së fundi, Mbrojtja parashtron se do të kërkojë ndryshimin e afatit të përcaktuar në Vendimin Kornizë për të treguar se cilat materiale të renditura në njoftimin e hollësishëm të ZPS-së për provat sipas rregullës 102(3) do të kërkojë t'i bëhen të njohura nëpërmjet nxjerrjes ose këqyrjes (përkatesisht për më datën 7 shtator 2021), duke qenë se Kërkesa për Shtyrje të Afatit, në qoftë se miratohet, do të ndikojë në mundësinë e Mbrojtjes që t'i përmbahet këtij afati.¹⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat e faktet relevante në zotërim të ZPS-së, të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit, i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë tij, dhe u nënshtrohen vetëm

¹³ Kërkesa për Shtyrje të Afatit, para. 3.

¹⁴ Kërkesa për Shtyrje të Afatit, para. 4.

¹⁵ Përgjigjja, para. 2.

¹⁶ Përgjigjja, para. 3.

¹⁷ Përgjigjja, para. 4.

¹⁸ Përgjigjja, para. 5.

atyre kufizimeve që janë rreptësisht të domosdoshme dhe atëherë kur zbatohen garancitë mbrojtëse kompensuese të nevojshme.

10. Në pajtim me rregullën 81(1)(a)-(b) të Rregullores, pas urdhërimit prej një Paneli të masave mbrojtëse lidhur me një dëshmitar, viktimë pjesëmarrëse në procese të tjera gjyqësore, ose persona të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së dhënë prej një dëshmitari, këto masa: (i) mbeten në fuqi *mutatis mutandis* në çfarëdo procesi të mëpasshëm para Dhomave të Specializuara ose në një juridiksion tjetër, përveçse dhe deri kur të ndryshohen në përputhje me rregullën 81 të Rregullores; dhe (ii) nuk e pengojnë ZPS-në që të përmbushë çfarëdo detyrimi për nxjerrje materiali sipas Rregullores në një proces të mëpasshëm, me kusht që ZPS-ja të informojë Mbrojtjen të cilës po i bëhet i njohur materiali, për llojin e masave mbrojtëse të urdhëruara dhe detyrimin për respektimin e tyre.

11. Në pajtim me rregullën 95(2)(b) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton, ndër të tjera, afatet për nxjerrjen e materialeve dhe merr masa për të mundësuar nxjerrjen e materialeve në kohë.

12. Në përputhje me rregullën 102(1)(b) të Rregullores, brenda afateve të përcaktuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe jo më vonë se 30 ditë përpara hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes këto materiale: (i) deklaratat e të gjithë dëshmitarëve që ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, në gjuhën që i akuzuari kupton dhe flet; (ii) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, aktekspertizat, deponimet ose transkriptet që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim; dhe (iii) provat materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim.

13. Në pajtim me rregullën 107(1) të Rregullores, në qoftë se Prokurori i Specializuar ka nën ruajtje ose kontroll informacion që i është dhënë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja, një informacion i tillë dhe burimi përkatës mbrohen sipas nenit 58 të Ligjit. Materiali ose informacioni fillestar nuk nxirren pa pëlqimin e dhënësit dhe në asnjë rast nuk paraqitet si provë materiale pa iu bërë i ditur paraprakisht të akuzuarit.

IV. DISKUTIM

A. [REDAKTUAR]

14. [REDAKTUAR].¹⁹

15. [REDAKTUAR].²⁰ [REDAKTUAR].²¹ [REDAKTUAR].²² [REDAKTUAR].

B. KËRKESA PËR SHTYRJE TË AFATIT

16. Për sa u përket materialeve që janë objekt i kërkesave të pazgjidhura ose të pritshme për masa mbrojtëse [REDAKTUAR], Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se ekzistojnë arsye të vlefshme për shtyrjen e afatit të ZPS-së lidhur me detyrimin e nxjerrjes së këtyre materialeve, për të mos rënë ndesh me qëllimin e masave mbrojtëse që janë objekt i kërkesave të pazgjidhura ose të pritshme [REDAKTUAR].²³ Gjithashtu, Mbrojtja njofton se nuk kundërshton shtyrjen e kërkuar të afatit. Rrjedhimisht, detyrimi i ZPS-së për nxjerrje lidhur me materialet e renditura në poshtëshënimin 4 të Kërkesës për Shtyrje të Afatit, shtyhet deri në lëshimin e vendimit mbi kërkesat përkatëse [REDAKTUAR].

17. Për më tepër, sikurse është përcaktuar më parë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'i shqyrtojë të drejtat e Mbrojtjes dhe do t'i vlerësojë ato kundrejt nevojës për masa mbrojtëse në lidhje me vazhdimin e zbatimit të masave mbrojtëse të miratuara në kontekst të proceseve të tjera gjyqësore.²⁴ Më tej vërehet se, sipas rregullës 81 të Rregullores, Mbrojtjes nuk i jepet mundësia për t'u shprehur nëse këto masa mbrojtëse duhet të mbeten në fuqi edhe në procese të tjera gjyqësore. Për këtë arsye, Gjykatësi i

¹⁹ [REDAKTUAR].

²⁰ [REDAKTUAR].

²¹ [REDAKTUAR].

²² [REDAKTUAR].

²³ [REDAKTUAR].

²⁴ [REDAKTUAR].

Procedurës Paraprake refuzon kërkesën e Mbrojtjes që t'i miratohet qasje në kërkesat e pazgjidhura ose të pritshme për masa mbrojtëse [REDAKTUAR] dhe të bëjë parashtrime përpara se këto masa, në qoftë se miratohen, të zbatohen në këtë proces gjyqësor.

18. Sa u përket materialeve të rregullës 102(1)(b) që janë objekt i kufizimeve sipas rregullës 107, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPS-ja është duke i shqyrtuar përgjigjet e dhënësve të informacionit dhe se Mbrojtja nuk kundërshton shtyrjen e kërkuar të afatit. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon shtyrjen e afatit të Prokurorisë lidhur me detyrimin e nxjerrjes së këtyre materialeve deri kur të përfundojë ky proces. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton ZPS-në që t'i japë përparësi shqyrtimit të përgjigjeve të dhënësve të informacionit në mënyrë që procesi i nxjerrjes së provave të vijojë sa më shpejtë.

19. Në lidhje me përkthimet në shqip të disa deklaratave të mëparshme të dëshmitarëve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se shtyrja e afatit të ZPS-së për nxjerrjen e këtyre materialeve deri në përfundimin e përkthimeve përlligjet, duke marrë parasysh faktin që versionet në anglisht tanimë janë nxjerrë si edhe parashtrimin e ZPS-së se përkthimet janë në kryerje e sipër. Gjithsesi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton ZPS-në për nevojën që t'u japë përparësi përkthimeve në fjalë, duke pasur parasysh se provat sipas rregullës 102(1)(b)(i) nxirren bashkë me përkthimet përkatëse, për t'i mundësuar Mbrojtjes përgatitjen e duhur dhe me kohë.

20. Sa i përket njoftimit të Mbrojtjes se do të kërkojë ndryshimin e afatit të përcaktuar në Vendimin Kornizë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do ta shqyrtojë këtë kërkesë në përputhje me dispozitat e zbatueshme në qoftë se parashtrohet dhe kur të parashtrohet zyrtarisht, dhe e konsideron të panevojshme të trajtojë më tutje parashtrimet e Mbrojtjes.

21. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Përgjigjja është klasifikuar si publike, ndërkohë që Mbrojtjes iu vu në dispozicion versioni i redaktuar konfidencial i Kërkesës për Shtyrje të Afatit. Në pajtim me rregullën 82(4) të Rregullores, përveçse

kur paneli urdhëron ndryshe, çdo përgjigje, kundërpërgjigje apo parashtrim tjetër në lidhje me parashtrimin e parë, ka të njëjtin status klasifikimi. Rrjedhimisht, Përgjigja duhej të ishte parashtruar si konfidenciale. Megjithatë, duke qenë se Përgjigja është më e përgjithshme dhe nuk zbulon ndonjë informacion konkret nga Kërkesa për Shtyrje të Afatit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon, në rrethana të jashtëzakonshme, se nuk ka nevojë që ajo të riklasifikohet. Gjithsesi, Mbrojtja udhëzohet që në të ardhmen t'u përmbahet dispozitave ligjore në lidhje me klasifikimin e parashtrimeve.

V. VENDIM

22. Për arsyet e mësipërme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) [REDAKTUAR]; dhe
- (b) **MIRATON** Kërkesën për Shtyrje të Afatit.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E enjte, 9 shtator 2021

Në Hagë, Holandë.